



## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit prill është realizuar monitorimi i dytë për afër 1000 mësimitdhënës të cilët janë në proces të trajnimit në kuadër të MKLSH-së. Me datat 20 përkatësisht 27 prill janë mbajtur takimet gjysmë-ditore për 32 grupe të mësimitdhënësve me ç'rast është diskutuar performanca e mësimitdhënësve me rastin e zbatimit të teknikave dhe strategjive të MKLSH-së. Raportet e trajnerëve tregojnë që pothuajse të gjithë mësimitdhënës të cilët kanë zbatuar me sukses teknikat dhe strategjitë, mirëpo problem ka paraqitur ora shumë e shkurtër mësimore, numri i madh i nxënësve në paralele dhe njësitë e gjata mësimore. Trajnerët kanë dhënë këshilla të nevojshme mësimitdhënësve për të tejkaluar sa më lehtë këto pengesa. Gjatë javës së fundit të prillit është mbajtur edhe seminari i 7 për vlerësimin në 5 qytete të Kosovës, kryesisht seminari është mbajtur në ato grupe të mësimitdhënësve, të cilët nuk kanë kandidatë që vijojnë kurset pa shpëputje nga puna. Seminari i fundit për vlerësimin për 25 grupet tjera do të mbahet në pjesën e parë të muajit maj.



■ Po ashtu gjatë muajit prill është bërë monitorimi i mësimitdhënësve të komunës së Istogut dhe është mbajtur takimi gjysmë-ditor për diskutim të orëve të monitoruara. Në javën fundit të prillit është mbajtur edhe seminari i 6. Seminari i fundit do të mbahet në pjesën e parë të muajit maj.

### Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit prill u organizuan disa trajnime të cilat janë vazhdimësi e aktiviteteve të financuara nga MASHT. Me datat 11, 12 dhe 13 prill në Prishtinë u mbajtën dy trajnime avancuese për klasën e parë. Në këto trajnime morën pjesë një numër i madh i mësimitdhënësve të rajonit të Prishtinës. Po ashtu me datat 26, 27 dhe 28 prill në Gjilan u mbajt i njëjti trajnim me mësimitdhënës të rajonit të Gjilanit. Ndërsa në Gjakovë u mbajt trajnimi për klasën e tretë .



### Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Në kuadër të projektit “Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim”

më 18 prill u mbajt takimi një ditore i grupit punues për hartimin e politikave. Në këtë takim u prezantuan të dy politikat e hartuara. Pas prezantimit, pjesëmarrësit dhanë kontributet e tyre me ide dhe sugjerime të ndryshme.

■ Si vazhdimësi e punëtorisë tre ditore për hartimin strategjisë së veprimit të përbashkët të organizatave partnere në këtë Projekt (KEC, SBASHK dhe KAHCR), u mbajt punëtorja një ditore për definimin e objektivave të strategjisë.



### **Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II**

■ Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore ka mbajtur takimin në të cilin janë shqyrtuar projekt-propozimet e shkollave të ciklit të parë të PPPA II. Pritet që së shpejti KAGSh të publikojë vendimin për vlerësimin e këtyre projekteve.

Në takimin e KAGSh po ashtu është prezantuar lista e shkollave të propozuara për pjesëmarrje në ciklin e dytë të këtij projekti. Pritet që edhe vendimi për aprovimin e kësaj liste të bëhet i ditur së shpejti.

### **Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim**

■ Gjatë muajit prill në kuadër të këtij projekti është mbajtur Moduli i dytë i trajnimit “Edukimi për të Drejtën Shoqërore”. Në këtë trajnim pjesëmarrësit u trajnuan se si ti kuptojnë dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë për ti zbrëthyer stereotipet, të kuptuarit dhe format e shtypjes, si të zbatojnë strategjitë të cilat do t'iu ndihmojnë në transformimin e ambientit të tyre personal dhe institucional.



Pas tri ditëve trajnimi, pjesëmarrësit u certifikuan. Në këtë trajnim morën pjesë 16 persona.

■ Në vazhden e aktiviteteve të këtij projekti, më 24-27 prill në Strugë, u mbajt punëtorja për hartimin e kornizës së monitorimit për Strategjinë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian – komponenta e edukimit.



Në punëtori morën pjesë 26 persona, shumica pjesëtarë të komuniteteve. Rezultat i kësaj pune është drafti i parë i kornizës së monitorimit të Strategjisë. Planifikohet që gjatë muajit maj të mbahet edhe një punëtori në Prishtinë, me qëllim të rishikimit të këtij drafti, dhe finalizimit të tij.

### **Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**

■ Që nga 15 marsi i këtij viti Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) po bën mentorimin e projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Më konkretisht, KEC do të mentorojë tri projekte të realizuara nga shoqata "Durmish Aslano" në Prizren, OJQ "Qendra e Komunitetit Ashkali" në Dubravë dhe Bethany Christian Services (BCS) në Gjakovë, projekte këto që financohen nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Në kuadër të këtyre projekteve organizohen aktivitete jashtëmësimore, mësim shtesë dhe trajnime të ndryshme për nxënës, ndërsa synim i përbashkët i tyre është përmirësimi i integritetit të fëmijëve të komuniteteve përfituese në shoqëri.

Në kuadër të punës mentoruese, deri në dhjetor të këtij viti, KEC do të monitorojë këto Qendra përmes raporteve mujore dhe vizitave në terren, si dhe do të angazhohet në ngritjen e kapaciteteve implementuese të këtyre organizatave përmes organizimit të trajnimeve. Trajnimet do të organizohen për stafin e angazhuar në punë me fëmijët nga komunitetet RAE në këto Qendra, sikurse edhe për mësimdhënësit që punojnë në shkollat publike ku frekuentojnë nxënësit nga këto tri qendra të komuniteteve.

Kësisoj, gjatë këtij muaji është mbajtur një takim i përbashkët me koordinatoren e këtyre Qendrave dhe janë bërë vizita në të tri Qendrat për të parë nga afër fillimin e aktiviteteve me nxënës.



Takimi i përbashkët është mbajtur në Prizren më 10 prill 2008 dhe në të janë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e ndërsjellë, rolin e KEC dhe shkëmbimin e përvojave dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në mes tri Qendrave.

### **Access Microscholarship Program**

■ Në muajin prill, mësimi është zhvilluar sipas dinamikës së projektit. Mësimi ka vazhduar të mbahet me tri grupet. Grupet të cilat e ndjekin mësimin në Prishtinë do ta përfundojnë mësimin e gjatë javës së parë të muajit maj. Ndërsa grupi i Prizrenit vazhdon deri në fund të muajit, kur edhe përfundon i gjithë projekti. Gjatë muajit maj është parashihet të organizohen një numër i madh i aktiviteteve. Në fund të projektit nxënësit të cilët kanë qenë pjesë e këtij projekti do të pajisen me certifikata nga Ambasada Amerikane për mësimin e gjuhës angleze i cili ka zgjatuar dy vite.

---

## **Mbahet mbledhja e Bordit Drejtues të KEC**

Në mbledhjen e vet të rregullt, të mbajtur më 29 prill 2008, Bordi Drejtues i KEC aprovoi raportin narrativ dhe financiar për vitin 2007, si dhe planin e punës për vitin 2008.



Bordi Drejtues konstatoi se Qendra për Arsim e Kosovës është duke dhënë kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e sistemit të arsimit në Kosovë dhe përgëzoi personelin e KEC për sukseset e deritanishme.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*